

DOKUMENT POLITIKASH JO-PERIODIK

MAJ /2017



POLITIKA SHOIPTARE PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR DHE ROLI I OShC NË PERSPEKTIVËN E ANËTARËSIMIT NË BE

Ndërtimi i Rrjeteve Rajonale të OShC për Zhvillim Ndërkombëtar

Dorian Jano, Katedra Zhan Mone dhe Koordinator i Forumit të Politikave të Integritimit

Ky botim është pjesë e projektit “Organizatat e Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor për Zhvillim Global” mbështetur nga programi zyrtar Slovak i Ndihmës për Zhvillim, SlovakAid (Nr. SAMRS / 2015 / ZB2 / 1/2)



Katedra JeanMonnet pranë Universitetit Marin Barleti është e angazhuar për mësimdhënien dhe kërkimet shkencore, si dhe promovimin e një debati konstruktiv ndërmjet akademikëve, politikë bërësve, praktikuesve dhe ekspertëve të shoqërisë civile për çështjet që lidhen me integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor. Qëllimi është për të ri-gjallëruar hulumtimin dhe debatin akademik mbi politikën e re të zgjerimit të BE-së ndaj vendeve të mbetura të Ballkanit Perëndimor (BP) nëpërmjet një qasjeje multidisiplinare dhe përmes aktiviteteve të komunikimit.

POLITIKA SHQIPTARE PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR & ROLI I OSHC NË PERSPEKTIVËN E ANËTARËSIMIT NË BE

*Ndërtimi i Rrjeteve Rajonale të OshC për Zhvillim
Ndërkombëtar*

Autori: Dr. Dorian Jano,
Katedra Zhan Mone pranë Universitetit Marin Barleti,
Koordinator i Forumit të Politikave të Integritimit

May 2017

Mirënjohje:

Autori dëshiron të falënderojë të gjithë ekspertët dhe anëtarët e shoqërisë civile për bashkëpunimin. Një falenderim i veçantë për Marián Čaučík, për udhëzimet e tij, komentet e detajuara dhe shembujt e dobishëm. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e institucioneve që mbështetën këtë studim.

Politika Shqiptare për Zhvillim Ndërkombëtar & Roli i OShC në Perspektivën e Anëtarësimit në BE

1. Hyrje

Në kontekstin e hapjes së negociatave për anëtarësim në BE, Shqipëria duhet të jetë e përgatitur për të miratuar dhe zbatuar politikat e bashkëpunimit për zhvillim dhe ndihmës humanitare si pjesë e kapitullit 30 mbi Marrëdhëniet me Jashtë. Politika e bashkëpunimit për zhvillim dhe ndihmës humanitare, është një nga politikat kryesore të BE-së në arenën ndërkombëtare, së bashku me politikën e jashtme, atë të sigurisë dhe tregtisë. Që nga Traktati i Lisbonës, politika e bashkëpunimit për zhvillim dhe ajo e ndihmës humanitare janë politika të jashtme të BE-së më vehte, secila me komisionerin e vet respektiv. Objektivi kryesor i politikës evropiane të bashkëpunimit për zhvillim është çrrënjësja e varfërisë, siguri i një zhvillimi të qëndrueshëm, dhe promovimi të demokracisë dhe paqes në botë nëpërmjet nëntë fushave prioritare të ndërhyrjes: tregtisë dhe integritit rajonal, mjedisit dhe burimet natyrore, infrastrukturës, energjisë, zhvillimit rural, qeverisjes, demokracisë dhe të drejtave të njeriut, paqes dhe sigurisë, zhvillimit njerëzor, kohezionit social dhe punësimit.¹ Instrumenti kryesor për sigurimin e ndihmës për zhvillim është Fondi Evropian i Zhvillimit i financuar nga Shtetet Anëtare i cili nuk përfshihet në buxhetin e përgjithshëm të BE-së.² Ndërsa, politika evropiane e ndihmës humanitare është formuluar në dokumentin ‘konsensusi evropian për ndihmën humanitare’ dhe bazohet në parimet themelore të neutralitetit, humanizmit, pavarësisë, paanësisë dhe respektimit të të drejtës ndërkombëtare sa herë që vepron në përgjigje të krizave dhe fatkeqësive humanitare.³ Instrumenti kryesor është Mekanizmi i BE-së për Mbrojtjen Civile i cili koordinon ndihmën e shteteve anëtare drejt çdo vendi në botë i cili është goditur nga fatkeqësitë natyrore apo ato të shkaktuara nga njeriu.⁴

Ashtu si me politikat e tjera të BE-së, politika e bashkëpunimit për zhvillim dhe ndihmës humanitare reflektohet në *acquis* e BE-së, çka detyron vendet për anëtarësim të

¹ EU Commission (2016) Assessing the 2005 European Consensus on Development and accompanying the initiative “Proposal for a new European Consensus on Development” Strasbourg, 22.11.2016 SWD(2016) 387 final. Shih gjithashtu edhe faqen zyrtare të DG DEVCO (Directorate General for International Cooperation and Development) http://ec.europa.eu/europeaid/sectors/sectors_en.

² Për më tepër shih Fondi Evropian për Zhvillim (EDF) http://ec.europa.eu/europeaid/funding/funding-instruments-programming/funding-instruments/european-development-fund_en

³ Për më tepër rreth Konsensusit Evropian për Ndihmën Humanitare shih: http://ec.europa.eu/echo/who/humanitarian-aid-and-civil-protection/european-consensus_en.

⁴ Për më tepër rreth Mekanizmit të BE-së për Mbrojtjen Civile shih http://ec.europa.eu/echo/what/civil-protection/mechanism_en.

jenë në përputhje me legjislacionin dhe angazhimet ndërkombëtare të BE-së, të sigurojnë kapacitetet e nevojshme për të marrë pjesë, për të financuar dhe për të zbatuar asistencën ndërkombëtare për zhvillim. Megjithatë, gjatë procesit të negociatave për anëtarësim siç tregohet edhe nga eksperiencia e zgjerime të mëparshme, politika e zhvillimit dhe ajo e ndihmës humanitare është një *acquis* “i butë” me vetëm disa rregulla dhe procedura të mire-përcaktuara dhe nuk është një nga kushtet kryesore me prioritet të lartë për anëtarësimin në BE. Si rrjedhojë, për të dyja palët është relativisht e lehtë që të mund të arrijnë shpejt një marrëveshje gjatë negociatave për anëtarësim në BE. Politika e zhvillimit ndërkombëtar dhe ndihmës humanitare ka një shkallë presioni relativisht të vogël dhe me intensitet të ulët për sa i përket përshtatshmërisë,⁵ duke krijuar kështu kushtet për një marrëveshje të shpejtë ‘në letër’ por të vështirë për ta zbatuar atë më vonë. Për më tepër, përvoja e mëparshme e të qënurit vetëm vend ‘marrës’ dhe jo donator, pa struktura dhe strategji organizative, rrezikon që politikat e miratuara dhe institucionet e krijuara të mos funksionojnë siç duhet ose në të njëjtin kuptim si në vendet e tjera të BE-së. Kështu, çdo model i ‘të mësuarit shoqëror’⁶ është i rëndësishëm për tu konsideruar në fushën e politikës ndërkombëtare të zhvillimit gjatë procesit të anëtarësimit në BE, së pari për shkak të akteve (*acquis*) të pakta ligjore për politikën e zhvillimit dhe rrjedhimisht mungesës së kushtëzimit prioritar dhe direkt të BE-së; dhe së dyti për shkak të rëndësisë normative të kësaj politike, ndërveprimeve të shumta midis shteteve anëtare dhe institucioneve të BE-së, si dhe pranisë së ‘sipërmarrësve normativë’ në këtë fushë.⁷ Shembuj të të mësuarit shoqëror mund të përfshijnë takime të veçanta midis vendeve kandidatë dhe partnerëve të zhvillimit të BE-së, seminare të ndryshme trajnuese për zyrtarët e shteteve kandidatë të organizuara nga disa shtete anëtare ose një qasjen më sistematike të programeve të transferimit të njohurive dhe partneritetit (p.sh. Asistenca Zyrtare për Zhvillim në Evropën Qendrore-ODACE, Iniciativa e Donatorëve të Zhvillimit-EDI).⁸

Për sa i përket zhvillimit ndërkombëtar dhe asistencës humanitare, Shqipëria mbi të gjitha do të duhet të kalojë nga një vend marrës i ndihmës së huaj në një vend

⁵ Henriksson, P. T. (2015) “Europeanization of Foreign-Aid Policy in Central and East Europe: The Role of EU, External Incentives and Identification in Foreign-Aid Policy Adoption in Latvia and Slovenia 1998–2010”, *Journal of European Integration*, 37: 4, fq. 434.

⁶ Për një argument më teorik mbi modelin e ‘të mësuarit shoqëror’ dhe zbatimin e tij në politikën e zhvillimit në vendet e Ballkanit Perëndimor. shih Jano, D. (2016) “Challenges of Western Balkans to Implement EU Policies of Development Cooperation” in *International Conference Booklet Development and Democracy: Sustainable World with No One Left Behind*, PontisFoundation, Bratislava.

⁷ Lightfoot, S. & Szent-Iványi, B. (2014) “Reluctant donors? The Europeanization of international development policies in the new member states”, *Journal of Common Market Studies*, 52(6), fq. 1258.

⁸ Henriksson, P. T. (2015), *op. cit.*, fq. 438; Szent-Iványi, B. & Lightfoot, S. (2015) *New Europe's New Development Aid*, New York, Routledge, fq. 86-89.

pjesëmarrës aktiv në ofrimin e ndihmave humanitare dhe zhvillimit për vendet më pak të zhvilluara. Sot Shqipëria, si shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor, nuk ka përvojë në ofrimin e ndihmave vendeve të tjera në zhvillim, përveç disa vendimeve të kufizuara *ad hoc* dhe ndërhyrjeve në raste të fatkeqësive natyrore. Shqipëria do të duhet të përgatitet për krijimin e strategjisë së saj për bashkëpunim ndërkombëtar për zhvillim dhe ndihmës humanitare pasi nuk ekziston një model unik për bashkëpunimin me vendet në zhvillim. Për më tepër, përfshirja e shoqërisë civile në këtë proces është vendimtare sidomos në trajtimin e drejtësisë globale, solidaritetit dhe zhvillimit ndërkombëtar. Përveç kësaj, sindikatat ose organizatat fetare duhet t'i kushtojnë vëmendje edhe çështjeve të zhvillimit ndërkombëtar.⁹ Duke pranuar dobësinë e sektorit civil në Shqipëri, do të ishte e preferuar të ndërtohej në rrjetet rajonale të organizatave të shoqërisë civile (OShC) për zhvillim ndërkombëtar, veçanërisht me ato vende të cilat së fundmi kanë kaluan në procese të ngjashme (të anëtarësimit)si dhe kanë kontribuar në Shqipëri. Rrjetet rajonale të OSHC-ve janë mekanizmat e parë dhe më të suksesshëm për advokimi ndaj institucioneve publike si dhe për zbatimin e politikës ndërkombëtare të zhvillimit.

Në këtë kontekst, qëllimi i përgjithshëm i këtij dokumenti politikash është të prezantojë situatën aktuale të Shqipërisë në zhvillimin ndërkombëtar dhe ndihmën humanitare dhe ta krahasojë atë me praktikat më të mira nga vendet e tjera të rajonit. Një thek i veçantë do të vihet në rolin kritik që shoqëria civile duhet të luajë në politikën e zhvillimit ndërkombëtar në kontekstin evropian,¹⁰ si dhe përpjekjet për të identifikuar mundësitë dhe sfidat e integritit të OShC-ve shqiptare në bashkëpunimin rajonal të shoqërisë civile dhe rrjetet për zhvillim ndërkombëtar.

2. Përgatitja e Shqipërisë për Politikën e Zhvillimit Ndërkombëtar dhe Ndihmës Humanitare në kontekstin e Negociatave për Anëtarësim në BE

Shqipëria është përfituese e ndihmës së huaj dhe nuk ka as kuadër politikash dhe as struktura administrative për politikën e zhvillimit dhe të ndihmës humanitare. Megjithatë, disa hapa pozitivë janë ndërmarrë në drejtim të fillimit të përgatitjes për politikën e zhvillimit dhe ndihmës humanitare në kontekstin e anëtarësimit në BE.

⁹ Përfshirja e organizatave të besimit fetar është e rëndësishme për shkak se ato kanë rrjetet e tyre ndërkombëtare dhe puna e tyre fokusohet në prioritetet aktuale të zhvillimit të qëndrueshëm (SDG) të drejtësisë globale dhe solidaritetit. Në këtë aspekt, Shqipëria mund të kontribuojë në çështjet e Tolerancës Fetare ose siç është thënë nga Papa Françesku gjatë vizitës së tij në Shqipëri, Vëllazëria Fetare.

¹⁰ Për një argument më teorik shih: Lister, M. dhe Carbone, M. (2006) "Integrating Gender and Civil Society into EU Development Policy", in *New Pathways in International Development: Gender and civil Society in EU Policy*, Lister, M. & Carbone M. (eds), Aldershot: Ashgate, fq. 1-16.

Në lidhje me politikën e zhvillimit dhe ndihmën humanitare, Shqipëria është palë nënshkruese e Deklaratës së Mijëvjeçarit dhe mbështet Konsensusin e Montreit për financimin e zhvillimit.¹¹ Ajo ka dhënë ndihmë të kufizuara *ad hoc* për vendet jo-anëtare të BE-së në përgjigje të fatkeqësive natyrore. Nuk ka një buxhet të dedikuar për ndihmat humanitare apo një agjenci për administrimin e ndihmave humanitare. Ligji Nr. 9900, datë 2008/04/10 “Për rezervat materiale të shtetit” parashikon dispozitat në fushën e ndihmave humanitare. Këshilli i Ministrave merr vendime *ad hoc*, rast pas rasti, për të kontribuar në raste të fatkeqësive natyrore ndërkombëtare dhe emergjencave civile.

Kutija1: Vendime Ad-hoc të Këshillit të Ministrave për fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat civile ndërkombëtare, 2013 -2016

- *Vendim Nr. 43, datë 23.1.2013 “Për një Shtesë Fondi në Buxhetin e Vitit 2013, Miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme, për ofrimin e ndihmës humanitare” (100,000 \$) në Turqi për strehimin e refugjatëve sirianë, Fletorja Zyrtare Numri: 6.*
- *Vendimi KM datë 19.03.2014 “Dhënie Ndihme Financiare Komunës së Preshevës për Maternitetin e Preshevës (50,000 Euro)*
- *Vendimi KM nr.295, datë 22.5.2014 “Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin humanitar për përballimin e gjendjes së krijuar nga përmbytjet në Bosnjë-Hercegovinë”*
- *Vendimi Këshillit të Ministrave nr.631, datë 1.10.2014 Përdhënien e ndihmës financiare nga qeveria shqiptare për qeveritë e Bosnjë-Hercegovinës dhe Serbisë për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet në maj 2014, Fletorja Zyrtare Numri: 156*
- *Vendimi Këshillit të Ministrave nr.697, datë 6.8.2015 “Përdhënien e ndihmës financiare, nga qeveria shqiptare për qeverinë e Republikës së Maqedonisë, për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet në gusht 2015, në Tetovë”, Fletorja Zyrtare Numri: 144*
- *Vendimi Këshillit të Ministrave nr.600, datë 31.8.2016 “Përdhënien e ndihmës financiare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për qeverinë e Maqedonisë, për lehtësimin e pasojave të dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet në gusht 2016”, Fletorja Zyrtare Numri: 166*

¹¹ COM (2010) 680, Analytical Report accompanying the Commission Opinion on Albania 's application for membership of the European Union, Brussels, 9/11/2010, fq. 115-116.

Tabela1: Ndhimat Humanitare Shqiptare (2013 - 2016)

Viti	Shuma	Shteti	Arsyeja
2016	EUR 100,000	Maqedoni	Për lehtësimin e pasojave të përmbytjeve
2015	EUR 50,000	Maqedoni	Për lehtësimin e pasojave të përmbytjeve
2014	EUR 100,000 x 2	Serbi Bosnjë - Hercegovinë	Për lehtësimin e pasojave të përmbytjeve
2014	EUR 50,000	Serbi	Për Maternitetin e Preshevës
2013	USD 100.000	Turqi	Për strehimin e refugjatëve Sirianë

Burimi: Të dhëna nga Vendimet e Këshillit të Ministrave. Shih Kutija 1

Shqipëria do të duhet të miratojë kuadrin ligjor dhe material për ndihmën humanitare për vendet jo-anëtare të BE-së dhe ndihmën për mbrojtjen civile për Shtetet Anëtare dhe vendet jo-anëtare të BE-së, në përputhje me parimet e miratuara tashmë nga Bashkimi Evropian, veçanërisht Rregullorja 1257/96. Vendi do të duhet ti bashkohet Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së.¹²

Ministria e Punëve të Jashtme emëroi një person për të ndjekur çështjet e lidhura me politikën e zhvillimit të BE-së dhe ndihmën humanitare. (COM 2012). Sipas Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, Ministria e Punëve të Jashtme në bashkëpunim me MZHETTS do të duhet të hartojë dokumentin strategjik “Ndihma për politikën e zhvillimit dhe ndihmës humanitare”.¹³ Drafti duhet të jetë pjesë e politikës së jashtme të Shqipërisë, të formulohet në mënyrë të qartë interesat dhe preferencat e veçanta të vendit në fushën e bashkëpunimit për zhvillim duke pasur parasysh sasinë dhe cilësinë e ndihmës, fokusin tematik dhe gjeografik, si dhe qëllimin e ndihmës e cila duhet të bazohet në objektivat, vlerat dhe parimet e përbashkëta të politikës së zhvillimit të BE-së.¹⁴ Për më tepër, duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që shoqëria civile luan në

¹² COM (2016) Albania 2016 Report Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2016 Communication on EU Enlargement Policy, Brussels, 9.11.2016 SWD(2016) 364 final Commission Staff Working Document {COM(2016) 715 final}, fq.84

¹³ Kjo është hera e parë që Plani Kombëtar për Integrimin Evropian parashikon një dokument të tillë strategjik. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2017–2020, Janar 2017, i aksesueshëm http://www.integrimi.gov.al/files/documents_files/FZ_Nr12-Viti2017_VKM42_date25.1.2017.pdf.

¹⁴ Për shembull, Kroacia përcaktoi qëllimet e veta strategjike dhe gjeografike në lidhje me bashkëpunimin për zhvillim në vitin 2013. Gjeografikisht, Kroacia dëshironte të ishte e pranishme kryesisht në Evropën Juglindore (me fokus Bosnjë dhe Hercegovinë), Mesdheun Jugor (Marokun, Tunizinë dhe Sirinë) dhe Afganistanin. Tematikisht, Kroacia dëshironte të përqendrohej në arsimin, shëndetin publik, turizmin dhe zhvillimin e shoqërisë civile. Shih: Bosanac, Gordan (2013) “Development Cooperation in the Youngest EU Member State: About Challenges and Chances in Croatia”, Trialog: A Bulletin on EU Enlargement and NGOs N° 10.

politikën e zhvillimit në vendet e tjera të Evropës Qendrore Lindore, drafti duhet të ketë edhe një kornizë të mirë përcaktuar për organizatat kombëtare joqeveritare që synojnë të ofrojnë ndihmë në vendet e treta, si dhe mekanizmat për një ndërgjegjësimi pozitiv midis popullsisë.

Në 6 dhjetor 2016, Ministria e Integritimit organizoi takim konsultativ me përfaqësues nga ministritë e linjës (kryesisht, kryetarët e GNPIE-së) për projekt-PKIE-në 2017-2020 për kapitullin 30, megjithatë nuk ka pasur pjesëmarrje nga shoqëria civile dhe grupet e interesit, si dhe fokusi i takimin nuk ka qenë politikat e zhvillimit dhe ndihmës humanitare.¹⁵ Disa workshop-e dhe trajnime mbi çështje që lidhen me përputhjen e kapitullit 30 me qasjen e BE-së janë organizuar me mbështetjen e GIZ ose projektit SMEI, gjithsesi fokusi është politika e përbashkët komerciale e BE-së dhe jo politika e zhvillimit dhe ndihmës humanitare.¹⁶

Sot, Shqipëria mbetet në një fazë të hershme të përgatitjes në kuadër të politikës së zhvillimit dhe ndihmës humanitare të BE-së, pa ndryshime legjislative, kornizë të politikave, struktura dhe kapacitete administrative. Për më tepër, ndryshimi nga marrës tek donator i ndihmës së huaj do të kërkojnë edhe mbështetjen aktive të një shoqërie civile të mirë informuar.¹⁷

3. Rasti i Vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor në Trajtimin e Politikës për Zhvillim Ndërkombëtar dhe Ndihmë Humanitare në Kontekstin e Negociatave për Anëtarësim në BE

Në rastin e Shqipërisë, është e rëndësishme dhe e dobishme që për vitet në vazhdim të shqyrtohen dhe të nxirren mësim nga përvoja e mëparshme e vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor të cilat janë duke shqyrtuar politikën e zhvillimit dhe ndihmës humanitare në kontekstin e bisedimeve për anëtarësim në BE.

¹⁵ Raport mbi konsultimin public Për Planin Kombëtar për Integrimin European 2017 – 2020, Ministria e Integritimit Evropian, e aksesueshme http://www.integrimi.gov.al/files/documents_files/17-02-17-02-43-47Raport_per_takimet_konsultative_te_PKIE_2017-2020.pdf

¹⁶ P.sh. 1) Workshop-i për GP në Kapitullin 30, Datat e Trajnimit: 24 Maj 2011, Numri i pjesëmarrësve 11; 2) Workshop-i mbi Kapitullin 30: Marrëdhëniet me jashtë, organizuar nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike dhe projekti SMEI3, me datën 25 nëntor 2014; 3) Trajnimi i punës përgatitore për hartimin e Planit të Punës për Kapitullin 30 të organizuar më 7.07.2016 me mbështetjen e German Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ).

Shih respektivisht: Support to the Albanian Ministry of European Integration – SMEI II, Delegation Agreement No: 2009/212-033 (IPA 2008) Final Report – Draft, 1 September 2009 – 30 September 2011, fq.82; Annual Progress Report 2014, Albanian Contribution – Input II, May – September 2014, fq.7; Albanian Contribution - Input II to Annual Report of European Commission 2016, May - September 2016, fq. 483

¹⁷ COM (2010) 680, Analytical Report accompanying the Commission Opinion on Albania 's application for membership of the European Union, Brussels, 9/11/2010, fq. 115-116.

Me përjashtim të Kroacisë, e cila është shtet-anëtar i BE-së, vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor janë ende vende përfitues të ndihmës si dhe legjislacioni dhe strukturat përkatëse për politikën e zhvillimit janë të kufizuara.¹⁸ Deri më tani, vendet e Ballkanit kanë ofruar vetëm disa ndihma humanitare *ad hoc* rast pas rasti, veçanërisht në përballimin e fatkeqësive natyrore. Është e nevojshme që vendet nga Ballkani Perëndimor në proces anëtarësimi të krijojnë një njësi qeveritare përgjegjëse dhe kompetente për bashkëpunimin për zhvillim dhe ndihmë humanitare, zakonisht në Ministrinë e Punëve të Jashtme, e cila është e pajisur teknikisht dhe me personel kompetent për të monitoruar, planifikuar dhe koordinuar bashkëpunimin për zhvillim dhe ndihma humanitare. Edhe në rastin e Kroacisë, harmonizimi me politikën e zhvillimit të BE u përfundua vetëm në vitin 2011, datë në të cilën u vendos që Kroacia të bëhet një vend anëtar i BE-së; në këtë vit u miratua Strategjia Kombëtare e Ndhmës për Zhvillim si dhe Departamenti për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim u rrit në 5 ekspertë të cilët ishin trajnuar rregullisht, por Kroacia akoma duhej të vazhdonte të forconte kapacitetet e saja financiare dhe administrative në fushën e politikës së zhvillimit dhe ndihmës humanitare.¹⁹ Në vitin 2014, u krijua brenda Drejtorisë së Përgjithshme për Çështjet Multilaterale dhe Çështjeve Globale të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Evropiane, Drejtoria për Politikën e Zhvillimit Global, Bashkëpunimit për Zhvillim dhe Ndhmës së Huaj Humanitare ku në përbërje të saj kishte një divizion për planifikim dhe një tjetër për zbatimin e politikës së zhvillimit dhe ndihmës humanitare.²⁰ Nga Nëntori 2012, Kroacia ka krijuar një Grup Pune Ndërinstitucional për Bashkëpunimin për Zhvillim dhe Ndhmën Humanitare me anëtarë nga organet e administratës shtetërore, përfaqësuesit e sektorit publik, shoqërisë civile, sektorit privat dhe komunitetit akademik, me qëllim për të krijuar kuadrin e politikës së zhvillimit në përputhje me politikën ndërkombëtare, për të siguruar koherencën e politikës së zhvillimit në nivel kombëtar dhe për të propozuar udhëzime që do të mund të forconin efektivitetin e projekteve të bashkëpunimit për zhvillim.²¹ Mali i Zi ka krijuar një Drejtori të Përgjithshme për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Kulturor (DGECC), në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Integritimit Evropian, e cili po merr kompetencat dhe përgjegjësitë për zbatimin e politikës së zhvillimit dhe të ndihmës humanitare dhe më

¹⁸ Për një analizë më të detajuar rreth përgatitjes së Ballkanit Perëndimor në Politikën e Bashkëpunimit për Zhvillim shih: Jano, D. (2016), *op. cit.*, fq. 80 – 82.

¹⁹ Commission Staff Working Paper, Croatia 2011 Progress Report, SEC (2011) 1200 final, Brussels, 12.10.2011, fq.62-63

²⁰ Shih: Croatia: Policy Framework. E aksesueshme në http://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/hr-dp-july-2016_en.pdf

²¹ Shih: Questionnaire for EU-PCD report 2015: Contributions from member states – Croatia. E aksesueshme në https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/reply-croatia_en.pdf; si dhe Croatia: Policy Framework, *op. cit.*

konkretisht mbledhjen e të dhënave për ndihmën e ofruar, duke përgatitur metodologjinë e përlllogaritjes së vlerës së ndihmës si dhe do të synojë krijimin e kuadrit ligjor për operacionet që do ndërmerren.²² Në qershor të vitit 2015, Mali i Zi u bë shtet pjesëmarrës në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së (Ligji që Ratifikon Marrëveshjen ndërmjet Malit të Zi dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Malit të Zi në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së, Gazeta Zyrtare e Malit të Zi - Marrëveshjet Ndërkombëtare 3/15) me 10 punonjës në Seksionin për Mbrojtjen Civile dhe Ndihmën Humanitare, i cili është përgjegjëse për çështjet që kanë të bëjnë me ndihmën humanitare. Në vitin 2010, u krijua Njësia për Ndihmën Humanitare dhe Zhvillim si pjesë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Maqedonisë me dy zyrtarë përgjegjës për aktivitetet e saj. Megjithatë, nga komunikimi me përfaqësues të shoqërisë civile maqedonase, njësia nuk ka qenë funksionale, i ka munguar stafi i kualifikuar me njohuri dhe vullnet për të bashkëpunuar me shoqërinë civile.²³ Serbia e ka planifikuar por e ka shtyrë si krijimin e Njesisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme që merret me zhvillimin dhe ndihmën humanitare, ashtu edhe emërimin e një Koordinatori Kombëtar për koordinimin e zhvillimit dhe asistencës humanitare e cila do të konsolidonte dhe koordinonte plotësisht punën e të gjithë autoritetet dhe institucioneve shtetërore kompetente.²⁴

Për sa i përket kuadrit të politikave apo rregulloreve sektoriale, Kroacia miratoi në vitin 2008 ligjin për Bashkëpunimin për Zhvillim dhe Ndihmën e Huaj Humanitare (Gazeta Zyrtare nr. 146/2008) dhe në shkurt 2009 miratoi strategjinë e parë Kombëtare për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Zhvillim dhe Ndihmë Humanitare 2009-2014 (Gazeta Zyrtare nr. 24/2009), e cila është azhurnuar në shtator 2015 për periudhën 2015-2020 dhe është komponent kyç në politikën e jashtme Kroate.²⁵ Mali i Zi, më 30 korrik 2016, ka ndryshuar Ligjin për Mbrojtjen dhe Shpëtimin, në mënyrë që të kishte një harmonizim sa më të plotë me *acquis* e BE-së në fushën e mbrojtjes civile, duke përfshirë menaxhim dhe koordinim më të mirë në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit, financimit të sistemit etj.; Mali i Zi ka në plan gjithashtu të miratojë Ligjin për Bashkëpunimin për Zhvillim dhe Ndihmën Humanitare deri në fund të vitit 2017, ligji i cili do të sigurojë përputhjen e plotë me *acquis*-në e BE-së.²⁶ Serbia po planifikon për

²² European Commission (2014) Screening report. Montenegro: Chapter 30 – External relations, WP enlargement + countries negotiating accession to EU, MD 1/14. 16.01.14, available at http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/montenegro/screening_reports/screening_report_montenegro_ch30.pdf

²³ Written Communication – Questionnaire with Macedonian civil society representative, 13 Mars 2017.

²⁴ Shih *the revised National Plan for the adoption of the Acquis*, p.1337 E aksesueshme në http://seio.gov.rs/upload/documents/nacionalna_dokumenta/npaa/NPAA_2016_revizija_srp.pdf

²⁵ E aksesueshme në portalin qendror të këshillimit publik “e-Counselling”, a aksesueshme <https://esavjetovanja.gov.hr/ECon/MainScreen?entityId=1147>

²⁶ Shih: Action Plan on the remaining preparations in relation to legislation alignment, as well as alignment of international treaties with the *acquis* and improvement of administrative and control capacities to ensure full

miratimin e një ligji të ri ose amendimin e ligjit ekzistues për punë të jashtme, i cili duhet të përcaktojë kompetencën e politikës së zhvillimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme; ky ligj gjithashtu parashikon krijimin e një grupi pune ndërministror që do të përgatisë një projekt ligj për politikën e zhvillimit dhe ndihmën humanitare, si dhe për të zhvilluar një strategji dhe plan-veprimi. Megjithatë, këto dokumente janë shtyrë dhe drafti aktual i Ligjit të ri për Punë të Jashtme ka një frazë të vetme në preambulën e saj që i referohet zhvillimit dhe ndihmës humanitare, prandaj ka më shumë mundësi që rregulloret e funksionimit praktik të ofrimit të ndihmës humanitare dhe zhvillimit për vendet në zhvillim të specifikohen në akte nënligjore dhe rregullore të mëtejshme.²⁷ Në Maqedoni, afati paraprak për miratimin e Ligjit për Zbatimin e Politikës së Zhvillimit është shtyrë për vitin 2017.²⁸

Në lidhje me kapacitetet administrative dhe operacionale, janë organizuar vizita studimore dhe seminare me kolegë nga shtetet anëtare të BE-së. P.sh. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Integritet Evropian në Malin e Zi, ka organizuar dy takime në dhjetor të vitit 2015 me një grupi pune ndërministror për ndihmë humanitare dhe zhvillim, ku kanë qenë të ftuar përfaqësues të qeverisë kroate dhe sllovene për të ndarë njohuritë dhe përvojën e tyre në lidhje me metodologjinë dhe praktikën e shteteve anëtare të BE-së në fushën e zhvillimit dhe ndihmës humanitare.²⁹ Maqedonia gjithashtu ka dërguar dy diplomatë nga Ministria e Punëve të Jashtme për të marrë pjesë në një vizitë studimore në Slloveni dhe Kroaci me qëllim njohjen e organizimit politik dhe institucional të bashkëpunimit për zhvillim dhe ndihmë humanitare të Sllovenisë dhe Kroacisë, kjo për të mundësuar shkëmbimin e përvojave për procesin e negociatave për Kapitullin 30, si dhe për sfidat gjatë zbatimit të bashkëpunimit për zhvillim.³⁰

Për sa i përket angazhimit të shoqërisë civile në kontekstin e negociatave për anëtarësim në BE në lidhje me kapitullin 30, janë ndërmarrë studime për Kroacinë, Serbinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë (studimi për Shqipërinë është duke u përgatitur) nga projekti Trialog, të cilat pasqyrojnë situatën e shoqërisë civile dhe përfshirjen e tyre

implementation and enforcement of the *acquis* from the day of accession: Chapter 30 – External Relations, Government of Montenegro, 20 October 2016, fq.7.

²⁷ Badan, Oana R. (2014) TRIALOG Country Paper Serbia, October 2014, Vienna, fq.11

²⁸ National Programme for Adoption of the *Acquis* (NPAAA) Revision 2016, Government of the Republic of Macedonia, Secretariat for European Affairs, fq. 271.

²⁹ Shih: Action Plan on the remaining preparations in relation to legislation alignment, as well as alignment of international treaties with the *acquis* and improvement of administrative and control capacities to ensure full implementation and enforcement of the *acquis* from the day of accession: Chapter 30 – External Relations, Government of Montenegro, 20 October 2016, fq.7.

³⁰ National Programme for Adoption of the *Acquis* (NPAAA) Revision 2016, Government of the Republic of Macedonia, Secretariat for European Affairs, fq. 271.

në procesin negociator për çështjet e bashkëpunimit për zhvillim.³¹ Një praktikë e mirë është edhe takimet informuese përmbledhëse me OSHC-të, të organizuara nga Zyra Serbe për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile në bashkëpunim me ekipin negociator, me qëllim informimin e përfaqësuesve të shoqërisë civile mbi çështjet kryesore dhe detajet e procesit të shqyrtimit dypalësh për Kapitullin 30 (24 përfaqësues të OSHC-ve ishin të pranishëm në takimin informues).³² Përdorimi i Teknologjisë së Informimit është gjithashtu një mënyrë efikase për të informuar në kohë reale për statusin e negociatave. Për shembull, Serbia publikoi në ueb faqen zyrtare të ministrisë transmetimin direkt (*webstreaming*) të vlerësimit shpjegues të Kapitullit 30 për Marrëdhëniet me Jashtë, në të cilën morën pjesë nëntë përfaqësues të OShC-ve (më pak se 2% e rreth 500 përfaqësuesve të OShC-ve që frekuentonin transmetimin e vlerësimit shpjegues për të gjitha kapitujt e negociatave) nga shtatë organizata të ndryshme (Qendra Evropiane e Politikave, Sindikatat e Bashkuara të Pavarura, Rodnagrada – Vendi Am, Konfederata e Sindikatave Autonome të Serbisë, Rinia Moderne, Axhenda e Sigurisë Ballkanike, Klubi i Studentëve të Fakultetit të Sigurisë).³³ Përfshirja e përfaqësuesve të shoqërisë civile si anëtarë me të drejta të plota të grupeve negociatore të punës, krahas anëtarëve të tjerë të administratës publike, paraqet një alternativë tjetër të përfshirjes aktive në procesin e hartimit të rregulloreve dhe politikave publike. Në Malin e Zi, grupi i punës për kapitullin 30 ka 24 anëtarë, 2 prej tyre vijnë nga shoqëria civile.³⁴ Për më tepër në rastin e Malit të Zi, ka pasur një dialog mes qeverisë dhe shoqërisë civile për të inkurajuar shoqërinë civile të bashkëpunojë me OJQ-të ndërkombëtare dhe të angazhohet aktivisht në ndihmat humanitare jashtë vendit.³⁵ Një tjetër platformë efektive për pjesëmarrje të gjerë dhe monitorim të procesit të negociatave të BE-së ka

³¹ Shih TRIALOG country papers series, E aksesueshme në <http://www.trialog.or.at/country-papers-3> (Aksesuar në datë 30 mars 2017).

³² Shih: Annual report on the participation of CSOs in the negotiation process for the accession of the Republic of Serbia to the European Union in 2014, Office for Cooperation with Civil Society, The Republic of Serbia Government, fq.3.

³³ Shih: Badan, Oana R. (2014) TRIALOG Country Paper SERBIA, October 2014, Vienna, fq.16. Office for Cooperation with Civil Society (2014) Annual Report on the participation of CSOs in the negotiation process for the accession of the Republic of Serbia to the European Union, The Republic of Serbia Government, E aksesueshme në: <http://civilnodrustvo.gov.rs/media/2014/06/Report-on-CSOs-participation-in-negotiating-process-in-Serbia.pdf>

³⁴ Shih: Chapter 30 – Working Group, <http://www.eu.me/en/30/item/337-chapter-30-working-group>

³⁵ Në shtator 2016, takimi i parë i organizuar nga OJQ malazeze për zhvillimin ndërkombëtar dhe ndihmën humanitare përfshinte edhe përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Integritimit Evropian me qëllim për të shkëmbyer informacion mbi ecurinë e Qeverisë në krijimin e sistemit për ndihmë humanitare dhe bashkëpunim për zhvillim. Shih: Action Plan on the remaining preparations in relation to legislation alignment, as well as alignment of international treaties with the acquis and improvement of administrative and control capacities to ensure full implementation and enforcement of the acquis from the day of accession: Chapter 30 – External Relations, Government of Montenegro, 20 October 2016, fq.7.

qenë edhe Konventa Kombëtare për Bashkimin Evropian (NCEU) e cila mbledh në grupe pune shumë OShC dhe funksionon si një organ i përhershëm për të diskutuar në mënyrë të strukturuar dhe tematike me të gjitha palët e interesuara si dhe për të formuluar opinione dhe rekomandime. Në Serbi, grupi i punës për marrëdhënie me jashtë (dhe politikën e jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes) ka 23 anëtarë nga 19 organizata (0.3%)³⁶ që vijnë nga shoqëria civile, academia, biznesi dhe ekipi negociator të cilët merren veçanërisht me Kapitullin 30.³⁷ Ndërsa Konventa Kombëtare për Bashkimin Evropian në Shqipëri, është në fazën fillestare me vetëm 4 grupe pune (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore; Drejtësia, Liria dhe Siguria; Bujqësia dhe Siguria e Ushqimit; dhe Mjedisi), dhe nuk adreson kapitullin 30 si një nga kapitujt më sfidues për bisedime me BE-në.³⁸

4. Rrjetet rajonale të OShC për zhvillim ndërkombëtar

Shumica e raporteve nënvizojnë rëndësinë e rrjetëzimit të OSHC-ve dhe formave të tjera të bashkëpunimit ndërsektorial, megjithatë bashkëpunimi në projektet ndërkombëtare të shoqërisë civile shqiptare me OShC-të nga rajoni është i kufizuar, në vetëm disa rrjete joformale të krijuara *ad hoc*.³⁹ Është e vështirë të vlerësohet përqindja, cilësia dhe qëndrueshmëria e OShC-ve shqiptare të përfshira në disa partneritete dhe rrjete të bashkëpunimit ndërkombëtar, pasi kjo është një situatë e re për Shqipërinë, megjithatë ka pasur disa praktika të mira për t'u përmendur.

Në nivel rajonal, projekti i OShC-të të Ballkanit Perëndimor për Zhvillim Global ka iniciuar një rrjet të shoqërisë civile nga vendet e Ballkanit Perëndimor (përfshirë Shqipërinë) me qëllim ndërgjegjësimin publik, ngritjen e kapaciteteve, angazhimin në dialogun politik dhe integrimin e tyre në shoqërinë civile Evropiane në bashkëpunim për zhvillim.⁴⁰ Projekti është një praktikë e mirë për të filluar një proces të ndërtimit të platformave dhe për të bashkërenduar OShC shqiptare të cilat janë aktive në edukimin

³⁶ Organizatat e nëngrupit për Kapitullin 30: ISAC Fund, BIRN, European Movement in Serbia, Serbian Association of Managers, Academy of National Development, Beta, Public Policy Research Centre, Center for Applied European Studies, Serbian Business Club Privrednik, Center for Euro-Atlantic Studies (CEAS), Bambi, Belgrade Center for Security Policy, Chamber of Commerce and Industry of Serbia, FoNet, European Policy Center, Business Info Group, MK Group, Open Society Foundation, and the Ministry of Trade, Tourism and Telecommunications.

³⁷ Shih: <http://eukonvent.org/eng/external-relations-foreign-security-and-defence-policy/>

³⁸ Shih: <http://em-al.org/en/national-convention-on-eu-integration-assessment-and-recommendations-2015-2016/>.

³⁹ Për shembull, bashkëpunimi i OShC-ve shqiptare është më i kufizuar me organizatat serbe. Shih: Badan, Oana R. (2014) TRIALOG Country Paper Serbia, October 2014, Vienna, fq.17

⁴⁰ Shih: WesternBalkanCSOsfor Global Development, i aksesueshëm në http://www.horizont3000.at/wp-content/uploads/2015/09/TRIALOG_Westbalkan.pdf; dhe <http://www.balkancsd.net/novo/wp-content/uploads/2016/06/globalen-razvoj.pdf>.

për çështjet e zhvillimit global dhe për t'i integruar ato në rrjetet ekzistuese të zhvillimit. Në mënyrë që OShC të Ballkanit Perëndimor të jenë partnerë në asistencën për zhvillim, e vetmja zgjidhje në këtë moment është nëpërmjet partneriteteve me vendet e tjera nga Evropa Qëndrore.⁴¹ Është e rëndësishme që organizatat e Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor të ndërliken me organizata në vendet e BE të cilat kohët e fundit kanë kaluar nëpër një proces të ngjashëm (si p.sh. vendet e Evropës Qëndrore) për shkëmbimin e përvojave në krijimin e strukturave të bashkëpunimit për zhvillim dhe mekanizmave për advokim me qeveritë kombëtare. Duke u ndalur në rrjetëzimin proaktiv me një gamë të gjerë të OSHC-ve, duke përfshirë akademikët, institucionet fetare, organizatat për zhvillim dhe cilindo që mund të ketë një qasje ndërkombëtare, është thelbësore për ndërtimin e platformave, rrjeteve rajonale dhe takimeve me ekspertë të tjerë.⁴² Bashkëpunimi rajonal dhe zbatimi i projekteve të përbashkëta me OShC në vendet fqinje dhe me më shumë përvojë në çështjet e zhvillimit është i rëndësishëm në ndërtimin e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin e OShC shqiptare në çështjet e zhvillimit ndërkombëtar dhe në përgatitjen e shoqërisë civile shqiptare për këtë proces. Pavarësisht përfshirjes së OShC shqiptare në iniciativat rajonale për ngritjen e kapaciteteve në çështjet e zhvillimit, nga sa jemi të informuar, sot nuk ka asnjë organizatë civile shqiptare që punon ose që ka qenë aktive në zbatimin e projekteve të bashkëpunimit për zhvillim në vendet e tjera në zhvillim. Takime rajonale për edukimin në çështje të zhvillimit ndërkombëtar me pjesëmarrësit nga vendet e Ballkanit janë organizuar në bashkëpunim me organizatat në BE që kanë kaluar nëpër procese të ngjashme (p.sh. platforma kroate CROSOL, Fondacioni Sllovak Pontis, Horizont 3000 i Austrisë). Organizatat të cilat kanë pasur më parë përvojë në programe të zhvillimit dhe ndihmës mund të adoptohen më lehtë kur vendi të bëhet një shtet anëtar i BE dhe donator i ndihmës së huaj. P.sh. AidWatch Serbia është një koalicion i 14 OSHC që aktualisht veprojnë si mbikëqyrës për monitorimin e shpenzimeve të ndihmës ndërkombëtare të merr Serbia, me perspektivë që të përdori këtë përvojë sapo Serbia të bëhet një vend donator i asistencës për zhvillim dhe ndihmës humanitare; AidWatch Serbia gjithashtu po bashkëpunon me Platforma Evropiane të OSHC për bashkëpunim për zhvillim për të

⁴¹ Iliana Nesikj, Program Menaxhere, Balkan Civil Society Network, Macedonia, në “The International Visegrad Fund Roundtable: Visegrad Partners and Western Balkan CSOs for Development”, in *International Conference Booklet Development and Democracy: Sustainable World with No One Left Behind*, PontisFoundation, Bratislava, fq.61.

⁴² Marián Čaučík, Drejtor i Dobranovina – Development Cooperation Programme of eRko, Slovakia, në “The International Visegrad Fund Roundtable: Visegrad Partners and Western Balkan CSOs for Development”, in *International Conference Booklet Development and Democracy: Sustainable World with No One Left Behind*, PontisFoundation, Bratislava, fq.58.

mësuar rreth mënyrave të tyre të punës dhe shkëmbimit të përvojave.⁴³ Rrjetet rajonale ndërlidhin OShC në Ballkanin Perëndimor me organizatat në BE, të cilat kanë kaluar nëpër procese të ngjashme për të ndarë njohuritë e tyre, për përgatitjen e tyre për zbatimin e projekteve zhvillimore dhe advokimin me qeveritë kombëtare dhe BE. Rrjetet rajonale të OShC janë mekanizmi më i mirë për të integruar dhe përkrahur axhendën e zhvillimit në vendet e Ballkanit Perëndimor, veçanërisht në Shqipëri.

5. Konkluzione

Në fushën e politikës së zhvillimit dhe të ndihmës humanitare, Shqipëria, si një vend kandidat që pret të hapë negociatat për anëtarësim, duhet të përgatitet për përputhjen me legjislacionin e BE-së dhe angazhimet e saj ndërkombëtare si dhe të sigurojë që Shqipëria do të ketë kapacitetin për të marrë pjesë në politikat e zhvillimit të BE-së. Rasti i negociatave për anëtarësim në BE me vendet e mëparshme, tashmë shtete-anëtare të reja, e kanë nënvlerësuar përgatitjen e një vendi kandidat për t'u bërë një vend donator, pasi bashkëpunimi për zhvillim dhe ndihma humanitare shpesh është trajtuar thjesht si një përmbushje aktesh formale në fund të negociatave për anëtarësim.⁴⁴ Hapja e bisedimeve me Shqipërinë për anëtarësim në BE do të duhet të gjenerojë në Shqipëri një hov të madh për të ndërmarrë masa të qarta dhe konkrete në politikën e zhvillimit dhe ndihmës humanitare. Të gjitha palët e interesuara, që nga zyrtarët e shtetit dhe politikbërësit, shoqëria civile e deri tek publiku i gjerë duhet të angazhohen në këtë proces në mënyrë që të arrihet legjitimiteti dhe mbështetja për rolin e ri të vendit.⁴⁵ Gjatë procesit të anëtarësimit, është e nevojshme që Shqipëria jo vetëm të hartojë, miratojë dhe zbatojë një numër dokumentesh strategjike, por gjithashtu të mund të ketë një kuptim të qartë të politikës së zhvillimit të BE dhe të krijojë infrastrukturën e duhur administrative me personel adekuat dhe të trajnuar në mënyrë efektive për të kontribuar në çështjet që shqetësojnë vendet në zhvillim. Megjithëse nuk ka një afat kohor të detajuar për negociatat me BE si dhe duke u nisur nga predispozita se politika e zhvillimit nuk është prioritet, duket se përgatitjet për politikën e zhvillimit dhe ndihmën humanitare do të shqyrtohen afër fundit të procesit të negociatave. Megjithatë, përvoja nga vendet e tjera tregon se politikat për zhvillim dhe ndihma humanitare duhet të trajtohen në kohën e duhur për të siguruar që Shqipëria është përgatitur plotësisht dhe në mënyrë efektive për rolin e saj të ri si donator i ndihmës së huaj.

⁴³ Shih: Steel-Jasińska, Rebecca (2014) 'Foreword' in Oana Raluca Badan *TRIALOG Country Paper Serbia*, Vienna, fq.17.

⁴⁴ *Ibid.*, fq.3.

⁴⁵ *Ibid.*

Sa i përket **ndërtimit institucional**, roli i MPJ duhet të jetë kryesisht në nivel të politikave, një mënyrë alternative për angazhimin e drejtpërdrejtë të MPJ-së do të ishte krijimi i një agjenci të specializuar me një Koordinator Kombëtar nën Kryeministri. Kjo njësi dhe autoriteti i tij nën zyrën e qeverisë do të ishte në kompetenca më të mirë për të koordinuar punën e të gjitha autoriteteve shtetërore dhe institucioneve kompetente si dhe mundëson qëndrimin jashtë presioneve dhe interesave të ndryshme diplomatike. Sa i përket **politikave**, është e rëndësishme që një vend anëtar i BE-së të ndihmojë qeverinë (p.sh. Gjermania në rastin e Rumanisë) në hartimin e strategjisë “Ndhima për politikën e zhvillimit dhe ndihmën humanitare” si dhe konsultimin me shoqërinë civile që në fazën fillestare përgatitore. Sa i përket shpërndarjes së buxhetit, sugjerohet që buxheti i parë të bashkë-financohet dhe nga një donator tjetër i shteteve anëtare të BE-së, kështu që të jetë një shumë dinjitoze, si dhe të alokohen fonde edhe për palët lokale të interesuara. Sa i përket **shoqërisë civile** është e rëndësishme të identifikohen organizatat e shoqërisë civile, të cilat do të kishin potencial për të kontribuar në projekte, edukim dhe sensibilizim për zhvillimin ndërkombëtar. OShC-të që veprojnë si vëzhgues për monitorimin e shpenzimeve të ndihmës ndërkombëtare mund të përdorin këtë eksperiencë sapo Shqipëria të bëhet donatore e zhvillimit dhe ndihmës humanitare. Mbështetje e caktuar nga vendet e tjera që kanë përvojë në bashkëpunimin për zhvillim dhe ndihmën humanitare është një domosdoshmëri. Përvoja e vendeve të Vishegradit siç po ndodh tashmë përmes TRIALOG, Fondacionit Pontis, mund të zgjerohet përtej vetëm një projekti duke bashkëshoqëruar OShC shqiptare në procesin e përgatitjes. Përfshirja e OShC-ve në procesin e anëtarësimit është një faktor i rëndësishëm në përparimin e politikës për zhvillim. Gjatë 25 viteve të fundit, jemi dëshmitarë të një roli në rritje të shoqërisë civile në Shqipëri, pavarësisht sfidave. Prandaj, është mirë të inkurajojmë përfshirjen aktive të OShC shqiptare në rrjetet rajonale për zhvillim.

Në përgjithësi, ajo që nevojitet është një qasje më sistematike për të pasur programe afatgjata ku zyrtarët qeveritarë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile të ftohen të marrin pjesë si vëzhgues në takimet në nivel Evropian të politikave të bashkëpunimit për zhvillim si dhe të përfshihen aktivisht në projektet e zhvillimit dhe në iniciativat globale të edukimit brenda rrjeteve dhe takimeve rajonale për zhvillim ndërkombëtar.

*Dokumenti i politikave nga Dorian Jano,
Pedagog i Katedrës Zhan Mone dhe
Koordinator i Forumit të Politikave të
Integrimit, diskuton situatën aktuale në
Shqipëri dhe praktikën më të mira të
mundshme në trajtimin e politikës për
zhvillim ndërkombëtar dhe ndihmës
humanitare nën dritën e hapjes së
negociatave për anëtarësim në BE*

EU POLICY HUB

EU Policy Hub është një Forum profesionistësh të rinj të cilët aspirojnë integrimin e Shqipërisë në familjen evropiane ku larmia e vlerave dhe dialogu janë urat që na bashkojnë

Misioni i Forumit është të kontribuojë në krijimin e sinergjive për integrimin e evropian të vendit nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të një strukture profesionistësh të rinj, të cilët promovojnë, monitorojnë dhe ndikojnë në ecurinë e procesit.